



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.21.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SHITËRPCËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Shtërpces në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Bujar Sejdiu (Udhëheqës i ekipit), Mehmet Kurti, Svetlana Perovic dhe Kreshnike Haziri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	25
6 Konkluzioni i përgjithshëm	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	27
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	29

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport i auditimit është një përmbledhje e çështjeve kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Komunën e Shtërpçës. Dëshiroj ta falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ne kemi kryer auditimin e PVF për vitin 2012 në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Vlerësimin nëse PVF paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale;
- Menaxhimin Financiar dhe Auditimin e Brendshëm, duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit; dhe
- Procedurat e pajtueshmërisë.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 - Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshinë një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i Çështjes* - Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(ISSAI 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes)

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Vlerësimet tona janë se Komuna e Shtërpcës ka pasur përmirësime gjatë vitit 2012, megjithatë sistemi aktual i kontrolleve të brendshme ende nuk ofron sigurinë e mjaftueshme që komuna të përmbushë në mënyrë të suksesshme objektivat e saj. Gjatë auditimit ne kemi hasur dobësi në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar.

Dobësitë e identifikuara janë shpalosur në vijim:

Rekomandimet e auditimit synojnë që të mbështesin komunën për funksionalizimin dhe forcimin e manxhimit financiar dhe kontrollit. Ne kemi rishikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve tona të dhëna nga auditimi i vitit paraprak. Si rrjedhojë ne mund të konkludojmë që Komuna e Shtërpcës nuk është angazhuar mjaftueshëm për implementimin e rekomandimeve tona.

Ne kemi identifikuar një planifikim të dobët të të hyrave vetanake të komunës. Plani fillestar i të hyrave parashikonte inkasimin prej 171,400€, ndërsa ishin mbledhur 331,840€;

Shpalosjet e pasurive mbi dhe nën 1,000€ ishin jo të plota, dhe nga pasqyrat financiare nuk dihet gjendja e tyre përfundimtare;

Një sërë dobësish janë identifikuar në fushën e prokurimeve. Tejkalimi i shumave të kontraktuara me anekskontrata ishte deri në 194,372€, blerjet jashtë kontratave dhe niveli i dobët i mbikëqyrjes, janë vetëm disa nga dobësitë ekzistuese të procesit. Mungesë kontrollesh janë vërejtur edhe në fushën e shpenzimeve tjera. Shenzimet e telefonit dhe ato për dreka zyrtare nuk janë të justifikuar me dëshmitë e duhura;

Ndarja e subvencioneve është bërë me praktikën e vjetër dhe pa respektuar Rregulloren e Brendshme për dhënien e subvencioneve. Për më tepër është vërejtur mungesë e dokumentacionit të plotë dëshmuës për ndarjen e subvencioneve.

Menaxhimi i dobët i detyrimeve. Mbi 1.2 milionë ishin paguar detyrime të pa paguara nga viti 2011, dhe mbi 1 milionë kishin mbetur ende të pa paguara.

Gjendja me menaxhimin e pasurisë së komunës është jo-adekuate. Kemi vërejtur që ka mungesë të zyrtarëve për pasuri dhe logjistikë, si dhe komisionet për inventarizim nuk kanë qenë efektive.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- PVF-të duhet të përmbajnë të gjitha informatat dhe shpalosjet që kërkohen me Rregullën Financiare 07;

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Duhet të tregohet një përkushtim më i vendosur në adresimin e rekomandimeve. Plani i veprimit duhet të përpilohet duke përcaktuar qartë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve tona;
- Të bëhet një planifikim më i mirë dhe i qëndrueshëm për tatimin në pronë dhe masa shtesë të merren në fushën e inkasimi. Një monitorim i vazhdueshëm i rezultateve të inkasimit nga të gjitha burimet e të hyrave është i nevojshëm;
- Përmirësimet në procesin e prokurimit duhet të fokusohen në planifikim dhe analizim më të mirë të kostove të projekteve, në mënyrë që mos të ndodhin tejkalime të pa kontrolluara të shpenzimeve (punë shtesë) për projektet kapitale. Blerjet jashtë kontratave duhet të vihen nën kontroll si dhe të forcohen kontrollet e mbikëqyrjes së projekteve. Po ashtu shpenzimet tjera operative (telefonike, drekat, etj.) duhet të vendosen në kuadër të limiteve të lejuara dhe të dokumentohen me evidencat e duhura;
- Gjatë dhënies së subvencioneve duhet të respektohen procedurat e parapara me Rregulloren e brendshme. Duhet pasur parasysh faktin se asnjë subvencion nuk do të ndahet pa kompletimin e dokumentacionit;
- Duhet të vendosen kontrolle rigorozë lidhur me detyrimet. Pagesa e detyrimeve të pa paguara nga vitet e mëparshme duhet të jetë prioritet në politikat buxhetore, krahas forcimit të kontrolleve që të mos hyhet në kontrata para se fondet të jenë zotuar; dhe
- Zyrtari i pasurisë dhe logjistikës duhet të emërohen dhe duhet të funksionalizohen komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Ne sugjerojmë themelimin e Komitetit të Auditimit, me qëllim të fuqizimit të rolit të auditimit të brendshëm.

Përgjigjia nga menaxhmenti

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Komunës së Shtërpcës të përgatis PVF-të sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Komunën e Shtërpcës. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur

përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna e Shtërpcës kishte përgatitur PVF në përputhje me kërkesat e definuara në Rregullën Financiare nr. 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Komuna ka përdorur formatin standard për përgatitjen e PVF-ve për vitin 2012.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur dhe dorëzuar në MF brenda afatit ligjor;
- PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Janë dorëzuar raportet e rregullta mujore për obligimet e papaguara; dhe
- Janë dorëzuar raportet e rregullta tremujore te Ministri i MF-së.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Përveç shpalosjes së plotë të pasurive, PVF-të ishin përgatitur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” ku është përdorur formati standard i raportimit.

Përshkrimi

Ne kemi dhënë kontributin tonë për t’u siguruar që PVF-të përmbajnë të gjitha shpalosjet dhe informacionet e plota shpjeguese të kërkuara me Rregullën Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP.

Mangësitë e identifikuara në PVF-të janë paraqitur në vijim:.

1. Çështja - Neni 16 Shpalosja e pasurive – Prioritet i rëndësishëm

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Në Nenin 16- Shënimi 30 dhe Shënimi 31- Shpalosjet e pasurive mbi dhe nën 1,000€ që janë pronë e komunës, nuk ishin paraqitur në shuma të plota. |
| Rreziku | Mos prezantimi korrekt i vlerës së pasurive shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës, si dhe mundësinë e keqkuptimit të kërkesave buxhetore në të ardhmën. Për më shumë, nuk është i mundur një menaxhim efektiv i pasurive. |
| Rekomandimi 1 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Është e nevojshme që menaxhmenti të monitorojë zbatimin e kësaj kërkesë. |

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i Çështjes* - Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(ISSAI 400: Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes)

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne gjatë auditimit kemi rishikuar implementimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i vitit paraprak. Ne e çmojmë veprimet e marra të menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve, por mendojmë që Komuna e Shtërpcës duhet të jetë më e përkushtuar në adresimin e plotë të rekomandimeve të dhëna.

Përshkrimi

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2011 të Komunës së Shtërpcës kishte rezultuar në 7 (shtatë) rekomandime kryesore. Komuna e Shtërpcës kishte përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet duhet të adresohen. Në Planin e Veprimit ishin përcaktuar masat e menaxhmentit dhe personat përgjegjës për implementimin e rekomandimeve.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që vetëm 1 (një) rekomandim është adresuar plotësisht; 4 (katër) rekomandime janë adresuar pjesërisht, dhe 2 (dy) rekomandime nuk janë adresuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i rëndësishëm

- E gjetura** Vetëm një rekomandim është adresuar plotësisht. Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar pjesërisht.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kyçe financiare të tilla si të hyrat, shpenzimet, subvencionet kanë rezultuar në vazhdimin e mangësive të njëjta dhe në raste të caktuara edhe me pagesa të parregullta (siç është rasti me subvencionet) dhe me përsëritjen e rekomandimeve.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve, me fokus fillestar në ato fusha me rëndësi më të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Ne gjithashtu e konsiderojnë vetë-vlerësimin e Komunës së Shtërpcës të ndërmarrë në kuadër të procedurave të MFK-së.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna e Shtërpcës kishte arritur të realizojë planin buxhetor në nivel të kënaqshëm, ngase në një anë kemi teprica buxheti prej 350,000€, ndërsa në anën tjetër, saldo e detyrimeve të përcjella në vitin 2013 kalon shifrën prej 1 milion euro.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Shtërpçës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është e pasqyruar në tabelat në vijim:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimet	2011 Shpenzimet	2010 Shpenzimet
Burimet e Fondeve:	2,918,750	4,352,502	4,003,868	3,890,375	3,754,893
Granti i Qeverisë - Buxheti	2,747,350	4,017,350	3,764,988	3,625,023	3,645,103
Të bartura nga viti paraprak	-	51,330 ²	50,745	50,675	34,118
Të hyrat vetjake	171,400	231,841 ³	136,698	185,773	63,542
Donacionet Vendore	-	-	-	-	5,000
Donacionet e Jashtme	-	51,981	51,437	28,904	7,130

Buxheti Final është më i lartë se Buxheti Fillestar për 1,433,752€ apo 49%. Kjo rritje e buxhetit ka ndodhur përgjatë vitit si rezultat i Rishikimit të Buxhetit, të hyrave vetjake duke përfshirë ato të bartura, Vendimit të Qeverisë dhe Grantet e Donatorëve. Shumat e fondeve që kontribuan në rritjen e buxhetit gjatë vitit 2012 ishin:

- Rishikimi i Buxhetit në shumë 500,000€
- Të Hyrat Vetjake në shumë 111,771€;
- Shumat e ndara me Vendime të Qeverisë 770,000€, dhe
- Grantet e Papërcaktuara të Donatorëve 51,981€.

Të gjitha lëvizjet buxhetore përgjatë vitit 2012 ishin të mbështetura me vendime të Kuvendit Komunal të Shtërpçës.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat e vetjake të planifikuara.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Shpenzimet	2011 Shpenzimet	2010 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,918,750	4,352,502	4,003,868	3,890,375	3,754,893
Pagat dhe Mëditjet	1,708,802	1,613,523	1,434,355	1,338,840	1,001,992
Mallrat dhe Shërbimet	332,125	456,402	334,963	340,372	177,808
Komunalit	76,471	82,547	82,546	55,941	33,155
Subvencionet dhe Transferet	5,000	5,000	4,999	10,314	5,600
Investimet Kapitale	796,352	2,195,030	2,147,005	2,144,908	2,536,338

Në Tabelën 2 vërejmë që buxheti është shpenzuar në shkallën 92%. Mund të thuhet që kjo është një shkallë e kënaqshme e performancës buxhetore të komunës.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të planifikuara dhe të mbledhura (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të Hyrat Vetanake	171,400	231,841	231,840	237,000	114,000

Nga tabela më lart shihet një rënie e lehtë e të hyarve në krahasim me vitin paraprak. Shpenzimet nga të Hyrat Vetjake gjatë vitit 2012 ishin të bazuara në Vendimet e Kuvendit Komunal dhe aprovimet nga Ministri i Financave.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne mund të konkludojmë që Komuna e Shtërpçës ka arritur t'i përmbushë kërkesat e raportimit. Ne e vlerësojmë raportimin e komunës në përmbushjen e procedurave dhe afatet e kërkuara.

Përshkrim

Legjislacioni në fuqi dhe Procedurat e MFK-së obligojnë çdo organizatë buxhetore që të respektojë kërkesat për raportim brenda afateve kohore të caktuara. Gjatë auditimit ne kemi parë që Komuna e Shtërpcës kishte përmbushur kërkesat për të cilat është e obliguar. Kërkesat e përmbushura nga kjo komunë ishin:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e shpenzimeve të komunës;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet Operacionale (performancës);
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve të dalura nga auditimi i vitit paraprak.

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim për këtë fushë.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Gjatë auditimit të të hyrave ne kemi vërejtur që komuna nuk ka një planifikim të mirëfilltë për inkasimin e të hyrave vetanake. Kontrollet e brendshme në fushën e të hyrave vetjake nuk funksionojnë në nivelin e duhur. Përkundër faktit që komuna kishte tejkuluar planifikimin për inkasimin e të hyrave, të arkëtueshmet nga debitorët e komunës janë në nivel të konsiderueshëm.

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Komuna e Shtërpcës në vitin 2012 ishin në total 231,840€. Komuna gjatë vitit 2012 ka inkasuar 12 lloje të të hyrave vetjake. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të hyrat nga tatimi në pronë, parkimi publik, lejet e ndërtimit, taksa rrugore etj.

3. Çështja - Llogaritë e Arkëtueshme - Prioritet i rëndësishëm

- E gjetura** Komuna e Shtërpcës nuk ka arritur të vendosë mekanizma efektiv për inkasimin e të hyrave vetjake. Llogaritë e arkëtueshme të komunës së Shtërpcës kanë arritur në 795,000€. Pjesën më të madhe të kësaj shume e përbëjnë debitorët për tatim në pronë, në shumë 738,000€. Ky borxh është akumuluar që nga viti 2003 dhe 52% apo 384,542€ janë borxhe të ndërmarrjeve nën administrimin e AKP-së.
- Rreziku** Politikat e planifikimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave, e po ashtu edhe kontrollet operative nuk janë efektive. Kësisoj mund të kemi një nënpagim të të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë, sjellin edhe dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve nga ky burim
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Kryetari i Komunës duhet të inicojë një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4. Çështja - Mos harmonizimi i të hyrave - Prioritet i rëndësishëm

- E gjetura** Ne kemi vërejtur raste dhe periudha kur nuk ishin bërë harmonizimet e të hyrave vetanake ndërmjet departamenteve që mbledhin të hyra dhe Drejtorisë së Financave. Sipas Drejtorisë së Financave për periudhën nëntë (9) mujore nga lejet për ndërtim ishin inkasuar gjithsej 18,083€. Ndërsa sipas evidencës së pranuar nga Drejtoria e Urbanizmit, shuma totale ishte 19,443€. Diferenca prej 1,360€ kishte ndodhur për shkak të mosbarazimit me kohë në mes Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Urbanizmit.
- Rreziku** Mos barazimet e të hyrave mund të rezultojnë në raportim jo të drejtë të të hyrave për menaxhmentin e komunës dhe rezulton në vendim marrje të bazuar në informata jo të sakta.
- Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të bëhen barazimet e rregullta në mes të departamenteve për gjenerimin e të hyrave dhe Departamentit të financave (të paktën në baza mujore) të mbështetura nga raportet formale, të cilat shpjegojnë arsyen për çdo mospërputhje të identifikuar.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Edhe pse edhe gjatë vitit 2011 ne kemi identifikuar një numër mangësish për zhvillimin e kontrolleve që kanë të bëjnë me shpenzimet dhe janë dhënë rekomandime përkatëse, është e qartë se komuna nuk ka arritur të kuptojë nevojën për kontrolle më të forta të sistemeve në këtë fushë. Prandaj, kërkohet zhvillim i mëtejshëm dhe forcim i kontrolleve të prokurimit dhe pagesave për mallra dhe shërbime si dhe për ndarjen e subvencioneve.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Gjatë vitit 2012 Komuna e Shtërpcës përmes procedurave të prokurimit kishte lidhur 98 kontrata në vlerë 2,786,796€. Po ashtu, kishe lidhur 4 aneks kontrata në vlerë 25,458€. Këtu përfshiheshin kontrata për punë, shërbime dhe furnizime.

Ne kemi parë që projektet për punë kanë qenë të parapara në Kornizën Afatmesme, Buxhetin e aprovuar dhe kanë kaluar përmes sistemit të PIP-it (Programi për Investime Publike). Ne nuk kemi hasur në ndonjë rast kur projekti ka anashkaluar PIP-in. Për të

testuar fushën e prokurimit, ne kemi testuar zbatimin e procedurave të prokurimit dhe mostra të pagesave nga investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet.

5. Çështja - Shkelje e Procedurave të Prokurimit dhe mbikëqyrje e dobët e projekteve - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Komuna kishte paguar një faturë në shumë 300,000€ për punët e kryera në projektin “Ndërtimi i tri (3) ndërtesave në Shtërpçë”. Për këto punë ishte lidhur një aneks kontratë në vlerë 346,674€ në vitin 2010. Kjo aneks kontratë tejkalonte 10% të lejuar sipas LPP për punë shtesë për 194,372€. Komuna kishte bërë kërkesë në APP për punë shtesë, dhe kjo e fundit e kishte aprovuar kërkesën me kusht që Komuna të mos tejkalojë 10% të kontratës bazë.

Komuna e Shtërpçës kishte lidhur kontratë për ndërtimin e Spitalit në Shtërpçë. Kontrata ishte lidhur në vitin 2010 ndërsa punët kishin përfunduar në vitin 2012. Vlera e kontratës ishte 1,382,171€. Gjatë rishikimit të pagesave kemi vërejtur që OE nuk kishte përdorur forma unike të situacioneve për paraqitjen e punëve të përfunduara dhe për kalkulimin e avansit të parapaguar. Madje edhe Organi Mbikëqyrës e kishte të pamundur të sqaronte përlogaritjet që ishin bërë nga OE. Projekti ishte pranuar teknikisht.

Gjatë testimit të pagesave të punëve të kryera për këtë projekt, kemi vërejtur që komuna kishte lidhur aneks kontratë për punë shtesë. Edhe në këtë rast komuna kishte bërë kërkesë në APP për punë shtesë. APP-ja e kishte aprovuar kërkesën me kusht që Komuna të mos tejkalojë 10% të kontratës bazë. Vlera e kontratës bazë ishte 1,382,171€. Aneks kontrata ishte lidhur më 16.12.2010 në vlerë 265,000€. Pra, kemi një tejkalimi të shumës së lejuar për punë shtesë për 126,783€.

Rreziku Tejkalmi i shumës së lejuar për punë shtesë është në kundërshtim me LPP-në dhe si i tillë rrezikon që të shkilen edhe kërkesat tjera të këtij ligji dhe të LMFPP-së. Shumat e tejkaluara për aneks kontratat janë bërë jashtë procedurave të prokurimit dhe kjo mund t'i sjellë komunës dëme financiare të pa justifikuar. Gjithashtu, niveli i dobët i mbikëqyrjes rritë rrezikun të jenë kryer pagesa jashtë cilësisë dhe sasisë së punimeve të kryera.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha aneks kontratat për punët shtesë të lidhen brenda limitit të përcaktuar me LPP-në. Për punë shtesë që tejkalojnë 10% të kontratës bazë duhet të procedohet me procedura të reja të prokurimit apo përdorimin e procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë. Organet mbikëqyrëse të projekteve duhet t'i forcojnë kontrollet e mbikëqyrjes dhe të kofirmojnë vetëm sasisë dhe cilësinë reale të punimeve.

6. Çështja - Tejkallim i kontratës – Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Komuna kishte lidhur kontratë me OE për furnizim me paisje dhe material shëndetësor, ku në specifikacionin teknik ishte kërkuar nga një njësi për çdo artikull. Kontrata me nr.02-16-2747 e datës 18.09.2012 ishte lidhur për furnizim me nga një njësi për çdo artikull të kërkuar dhe vlera e përgjithshme e saj ishte 48,470€. Në emër të së njëjtës kontratë, komuna kishte bërë furnizime në vlerë 95,000€.

Në një rast tjetër komuna kishte paguar faturën e datës 24.12.2012 në shumë 9,773€ për blerjen e dy paisjeve shëndetësore. Kontrata me OE "Atom Med" ishte lidhur më 17.12.2012 për blerjen e vetëm një paisjeje të tillë në vlerë 4,880€.

Rreziku Tejkallimi i shumës së kontraktuar prej 46,530 ishte bërë pa kurrëfarë procedure. Kjo është në kundërshtim me LPP-në dhe si i tillë konsiderohet pagesë e parregullt, me mundësinë që të jenë dëmtuar fondet e komunës.

Rekomandimi 6 Kryetari i Komunës duhet t'iu bëjë të ditur zyrtarëve të prokurimit dhe të financave se kontratat duhet të respektohen në mënyrë strikte, dhe asnjë furnizim apo pagesë shtesë nuk mund të bëhet jashtë kontrate.

4.5.2 Shpenzimet tjera

Përshkrimi

Me shpenzimet tjera nënkuptohet të gjitha shpenzimet që bëhen përmes modulit të aprovimit, pra pa procedura të prokurimit. Për të testuar këtë lloj të shpenzimeve, ne kemi marrur mostra të pagesave të komunalive dhe drekave zyrtare. Kemi vërejtur që shpenzimet për dreka zyrtare në vitin 2012 kanë shënuar rritje për 63% krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2011 ato ishin në shumë 19,000€ ndërsa në vitin 2012 arrinin shumën 31,000€.

7. Çështja - Drekat zyrtare - Prioritet tjetër

- E gjetura** Ne kemi testuar fatura të shpenzimeve për dreka zyrtare në shumë 5,165€. Kemi vërejtur që këto fatura nuk përmbanin evidencat e duhura mbi sasinë, llojin dhe qëllimin për fondet e shpenzuara.
- Rreziku** Mungesa e evidencave në faturat e shpenzimeve për dreka zyrtare paraqet rrezik që komuna të shpenzojë fondet publike pa justifikimet e duhura.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha faturat për dreka zyrtare të mbështeten me dëshmi shtesë mbi qëllimin e organizimit, numrin e pjesëmarrësve dhe të përmbajnë informata mbi sasinë e paguar.

8. Çështja - Shpenzimet e telefonit fiks dhe mobil - Prioritet tjetër

- E gjetura** Ne kemi vërejtur një rast që Komuna e Shtërpcës gabimisht kishte paguar dy herë të njëjtin borxh të akumuluar për telefon fiks. Shuma e paguar dy herë ishte 1,409€.
- Gjithashtu kemi vërejtur mungesë të kontrollit të shpenzimeve për kartela rimbushëse të telefonisë mobile. Furnizimi i drejtorive me kartela rimbushëse bëhet në bazë të Vendimit 02/136 të nxjerrur nga Kryetari i Komunës. Ky vendim nuk përcakton qartë autorizimet për përdorimin e kartelave. Përveç kësaj kemi konstatuar që nuk respektohet Pika 4 e këtij vendimi e cila kërkon që “Çdo drejtor duhet të menaxhojë me një listë të posaçme për kartelat rimbushëse”.
- Rreziku** Mungesa e kontrollit gjatë shpenzimit të telefonisë fikse dhe mobile mund të rezultojë me shpenzime të panevojshme dhe të pa autorizuara. Si pasojë komuna mund të përfundojë me mbi shpenzime të shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile.
- Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës duhet të përforcojë kontrollet për shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile. Vendimi për kartelat rimbushëse të telefonave mobil duhet t’i përcaktojë saktë autorizimet për përdorimin e tyre dhe duhet të respektohet çdo pikë e këtij vendimi.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna e Shtërpcës kanë të bëjnë me: autorizimin e sistemit të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme dhe barazimet e brendshme.

Shuma e buxhetuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2012 për Komunën e Shtërpcës ishte 1,613,523€. Komuna gjatë vitit 2012 kishte realizuar 1,434,355€ apo 89% të shumës së buxhetuar për vitin 2012.

Për të testuar rregullsinë e shpenzimeve nga kjo kategori ne kemi testuar 10 mostra. Testimi ynë ka përfshirë listën e punëtorëve të pensionuar, pushimet e lehonisë, rekrutimet, shkëputjen e kontratave të punës, kalkulimet e pushimeve si dhe dosjet e personelit.

9. Çështja - Dosjet e Personelit – Priorite tjetër

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Gjatë testimit kemi vërejtur që dosjet fizike të punëtorëve të Komunës së Shtërpcës nuk janë të kompletuara në bazë të kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA). Në disa raste mungojnë kopjet e letërnjoftimeve, diplomatat e shkollimit si dhe kalkulimet e pushimeve vjetore. Në të gjitha dosjet e testuara mungonte kopja e llogarisë bankare. Po ashtu Komuna e Shtërpcës nuk posedon dosje elektronike të punëtorëve. |
| Rreziku | Të dhënat nuk janë në dispozicion për ta justifikuar pagesat, si dhe për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve të vlerësimeve të performancës. |
| Rekomandimi 9 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit do të ndërmerret për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë, brenda një periudhe të specifikuar kohore. |

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Buxheti i Komunës së Shtërpcës për kategorinë e subvencioneve ishte simbolik - 5,000€, të cilat ishin shpenzuar në tërësi. Subvencionet janë dhënë për entitete publike, entitete publike kulturore, entitete jo-publike dhe përfitues individual.

10. Çështja - Shkelje e Rregullores dhe mungesë dokumentacioni - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Komuna e Shtërpcës kishte aprovuar një Rregullore të brendshme që përcakton procedurat dhe kriteret për dhënien e subvencioneve. Sipas rregullores, subvencionet deri në 500€ ndahen me vendin të Kryetarit, ndërsa më shumë se 500€ me vendim të Kuvendit Komunal. Poashtu, çdo kërkesë për subvencione duhet të shqyrtohet nga drejtori relevant. Ne kemi vërejtur që gjatë ndarjes së subvencioneve komuna nuk kishte respektuar këtë rregullore. Të gjitha subvencionet ishin ndarë me vendime nga Kryetari i Komunës, duke anashkaluar procedurat e parapara me Rregulloren e Brendshme.

Ne kemi vërejtur që komuna nuk posedon dokumentacion të plotë të përfituesve të subvencioneve. Për më tepër, Komuna nuk bën marrëveshje mirëkuptimi me përfituesit e subvencioneve për mënyrën e shpenzimit dhe të raportimit nga përfituesit ndaj Komunës

Rreziku Ndarja e subvencioneve duke shkelur rregulloren e brendshme tregon për mospërfillje të ekzekutivit të komunës ndaj akteve të cilat i ka miratuar vetë. Kjo sjellë në pikëpyetje objektivitetin gjatë përzgjedhjes së përfituesve. Mos dorëzimi i ndonjë raporti mbi shpenzimet kryera rrit rrezikun për shpenzim jashtë kriterëve të përcaktuara.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të respektohet Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe të gjitha subvencionet trajtohen sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, duke përfshirë edhe aspektin e raportimit.

4.6 Pasuritë

Konkluzion i përgjithshëm mbi pasuritë

Menaxhimi i pasurive në Komunën e Shtërpcës është sfidë për komunën dhe kërkon një çasje të përmirësuar. Komuna e Shtërpcës nuk ka bërë regjistrimin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK dhe plotësimin e regjistrit të pasurive nën 1,000€. Vlera e pasurive e prezantuar në PVF nuk paraqet pamjen reale të pasurive në posedim të komunës.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Ne kemi vërejtur që Komuna e Shtërpcës nuk ka bërë regjistrimin e pasurive të saj në SIMFK dhe në sistemin e-pasuria. Menaxhimi i pasurisë është përcjellur me mangësi të ndryshme.

11. Çështja - Regjistrimi i pasurive në SIMFK dhe E-pasuria - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Ne kemi konstatuar që vetëm pasuritë e përfituara nga pagesat e palëve të treta në komunë janë regjistruar në SIMFK. E tërë vlera tjetër e pasurisë së komunës vazhdon të mbetet e paregjistruar në SIMFK. Poashtu Komuna e Shtërpcës posedon një regjistër të plotë të pasurive nën 1,000€.

Rreziku Mos regjistrimi i pasurive në SIMFK, bën të pamundur pasqyrimin e saktë të gjendjes së pasurive dhe vështirëson aspektet menaxheriale të vendimmarrjes.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet që plotësojnë kriteret për t'u regjistruar në SIMFK apo regjistrin e pasurisë, të regjistrohen pa marrë parasysh se përmes cilës formë janë përfituar.

12. Çështja - Mungesa e zyrtarit për pasuri dhe logjistikë - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Komuna ende nuk ka emëruar zyrtarë të veçantë për pasuri dhe logjistikë. Kjo ka rezultuar me ngecje në evidentimin dhe regjistrimin e pasurisë së komunës.

Komisioni për regjistrim poashtu nuk ka përfunduar regjistrimin, kështu që regjistri i pasurisë në posedim të komunës nuk është i kompletuar.

Rreziku Mungesa e zyrtarëve për pasuri dhe logjistikë është një mangësi thelbësore në menaxhimin e pasurive. Mungesa e evidencave të plota mbi pasuritë mund të rezultojë me vendimmarrje të gabuar nga ana e menaxhmentit.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që brenda një afati optimal të emërojë zyrtarë të veçantë për pasuri dhe logjistikë. Nevojiten masa të menjëhershme që zyrtarët relevant të fillojnë me identifikimin e gjendjes së saktë dhe regjistrimin e pasurive si dhe vënien e tyre nën menaxhim të plotë.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzion i përgjithshëm

Gjendja e borxheve të Komunës së Shtërpcës vazhdon të jetë e rëndë. Obligimet e papaguara të Komunës së Shtërpcës më 31 Dhjetor 2012 arrinin shumën 1,076,000€. Këto janë borxhe të akumuluar vit pas viti.

Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte në shumë prej 2,302,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2012. Prej tyre gjatë vitit ishin paguar 1,226,600€. Në fund të vitit 2012 totali i obligimeve të papaguara arrinte shumën 1,076,000€.

Rekomandimet

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të përpilojë një strategji të qartë për mënyrën e shlyerjes së obligimeve të papaguara. Komuna duhet të ketë parasysh disponueshmërinë e fondeve para hyrjes në obligime dhe të bëjë pagesat e faturave brenda afatit ligjor.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte kryer gjashtë (6) auditime gjatë vitit 2012. Auditimet mbulonin aktivitetet e viteve paraprake dhe të vitit aktual. Mund të themi që Auditimi i Brendshëm (AB) ka bërë një punë të mirë gjatë vitit 2012. Megjithatë, mungesa e Komitetit të Auditimit vazhdon të dobësojë rolin e Auditimit të Brendshëm.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

Raportet e Auditimit janë të një kualiteti të kënaqshëm dhe mbulojnë fushat me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë. Për të gjitha auditimet menaxhmenti kishte përgatitur planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Rekomandim

Për të fuqizuar misionin e auditimit të brendshëm dhe sistemin e kontrolleve në përgjithësi, ne rekomandojmë Kryetarin e komunës që brenda një periudhe të caktuar kohore të merr në konsiderim themelimin e komitetit të Auditimit të brendshëm.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Komuna e Shtërpcës ka një dizajn të mirë të sistemit të kontrolleve të brendshme, por dobësitë vërehen në implementimin e kontrolleve. Menaxhmenti dhe stafi profesional i komunës nuk i kushton rëndësinë e duhur menaxhimit dhe kontrollit të mirëfilltë të financave publike.

Rekomandimet e auditimit paraprak ishin trajtuar vetëm pjesërisht, dhe rezultat i kësaj ishte përsëritja e dështimeve nga vitet e kaluara. Kjo qasje e menaxhmentit kundrejt rekomandimeve të auditimit, duhet të ndryshojë.

Më tutje, planifikimi dhe inkasimi i të hyrave vetjake nuk kanë konsistencë. Me planin fillestar të buxhetit ishte paraparë që ato të jenë për 38% më të ulta se realizimi në vitin 2011. Realizimi i të hyrave vetjake kishte rezultuar me një tejkalim të planit fillestar me 35%, por me rënie prej 2% nga realizimi i vitit paraprak. Llogaritë e arkëtueshme nga vitet paraprake për tatimin në pronë nuk janë për t'u neglizhuar.

Kontrollet e prokurimit janë përcjellur me dobësi serioze. Si pasojë, në vitet e mëparshme janë lidhur kontrata për punët shtesë që tejkalonin limitin prej 10% të paraparë me LPP-në, ndërsa disa pagesa janë kryer gjatë vitit 2012. Po ashtu gjatë furnizimit me paisje dhe materiale shëndetësore janë bërë tejkalime të shumave të kontraktuara.

Edhe blerjet përmes modulit të aprovimeve ishin përcjellur me gabime dhe mangësi. Shpenzimet e telefonisë mobile realizohen bazuar në një vendim të Kryetarit të Komunës, por ky vendim respektohet vetëm pjesërisht. Shpenzimet për dreka zyrtare kanë shënuar rritje enorme krahasuar me vitin paraprak. Për me tepër, këto shpenzime nuk ishin mbështetur me dëshmi të mjaftueshme mbi qëllimin e organizimit, numrin e pjesëmarrësve dhe sasinë e shpenzuara.

Edhe pas aprovimit të rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve, shpenzimet nga kjo kategori janë shoqëruar me parregullsi. Subvencionet ndahen me praktikën e vjetër duke anashkaluar procedurat e përcaktuara me rregullore. Kjo formë e ndarjes së subvencioneve shton rrezikun e devijimit të fondeve publike nga qëllimi i përcaktuar.

Dështimi i evidentimit dhe regjistrimit të pasurive në SIMFK, mungesa e regjistrimit të pasurive nën 1,000€, si dhe mungesa e zyrtarëve për pasuri dhe logjistikë tregojnë qartë që Menaxhimi i pasurive të komunës është në situatë kritike.

Gjendja e borxheve të Komunës së Shtërpcës është mjaft e rënduar. Komuna vazhdon të paguaj borxhe të mbetura prej shumë vitesh. Me gjithë zvogëlimin e borxheve, shumata mbetur prej 1,076,000€ mund ta çojë në vështirësi financiare, një komunë të vogël siç është Komuna e Shtërpcës.

Rekomandimi ynë përfundimtar është:

Kryetari i Komunës duhet që së bashku me ekipin e tij menaxhues t'i trajtoj me kujdes të gjitha gjetjet a raportit, në veçanti çështjen e procesit të prokurimit, të hyrave, detyrimeve të pa paguara dhe regjistrimin e pasurive. Pjesë e forcimit të kontrolleve menaxheriale duhet të jetë edhe menaxhimi i burimeve me qëllimin që të ndërprerjes së dukurisë së hyrjes në kontrata pa fondet e sigurta.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht te adresuara	Rekomandimet pjesërisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4. Rezultati financiar	Përgatitjen e buxhetit vetëm pas një analize gjithëpërfshirëse.		Është adresuar pjesërisht	
5. Pasqyrat Financiare	Në PVF të paraqes gjithë pasurinë e saj, si një kërkesë ligjore, dhe me këtë të kompletoj informatat e duhura.			Nuk është adresuar.
6.2.1 Prokurimi	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitjen e planit vjetor të prokurimit, duke i specifikuar qartë të gjitha projektet dhe nevojat për furnizime; dhe • Të forcoj kontrollin e monitorimit të kontratave, në mënyrë që punimet apo furnizimet të kryhen brenda afateve kontraktuese. 		Është adresuar pjesërisht	
6.2.3 Subvencionet	Përgatitjen e Rregullores së brendshme, duke specifikuar qartë kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, për të parandaluar çfarëdo parregullsish.	Është adresuar.		
6.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kompletimin e regjistrimit të pasurive në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 21/2009 mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive.			Nuk është adresuar.
7.1	Të bëj rishikimin funksional të kontrollit të brendshëm, në mënyrë normative ka		Është adresuar pjesërisht	

Kontrolli i Brendshëm	definuar procedurat e kontrollit dhe identifikimin e rrezikut si dhe ka krijuar një rrjedhë efikase të informimit dhe komunikimit brenda organizatës			
7.2 Auditimi i Brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> • NJAB kryesisht do të fokusohet në ndjekjen e aktiviteteve të vitit aktual dhe në fushat më problematike, si: prokurimi dhe pasuritë; dhe • Të formoj Komitetin për auditim në afat sa më të shkurtër, me çka do të fuqizonte funksionin e auditimit të brendshëm. 		Është adresuar pjesërisht	